

RREGULLORE NR. 2001/11

PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR

Përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr.1999/1 datë 25 korrik 1999 të Misionit të Përkohshëm të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/16 të datës 6 nëntor 1999 mbi Autoritetin Qendror Fiskal dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2000/20 të datës 12 prill 2000 mbi Administratën dhe procedurat tatimore.

Duke pasur parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/3 të datës 22 janar 2000 për Tatimin në shitje në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/5 të datës 1 shkurt 2000 për Vendosjen e tatimit në hotele, ushqim dhe pije në Kosovë,

Me qëllim të vendosjes së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) në Kosovë dhe shfuqizimin e Rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2000/3 dhe 2000/5,

Shpall sa vijon:

Kapitulli I
Përkufizime

Neni 1
Përkufizime

Sipas kësaj Rregulloreje:

1.1 “Borxhi i keq” nënkupton një pagesë që duhet arkëtuar nga personi i tatueshëm, që është përfshirë më parë në të ardhurat e këtij personi të tatueshëm dhe përkundër faktit se janë ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për ta arkëtuar borxhin, ai mbetet i paarkëtuar.

1.2 “Mjeti kryesor” nënkupton një mall (si psh., pajisjet apo makineria) që shfrytëzohet për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve të tjera.

1.3 “Konsideratë” nënkupton një pagesë, një akt a ndonjë shtyrje pagese në kohë lidhur me furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë shumën që është e pagueshme ose mallrat e marra në një transaksion bartër (mall për mall).

1.4 “Notë krediti” nënkupton një dokument të lëshuar nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave dhe shërbimeve pasi është lëshuar fatura tatimore, e cila leshohet me qëllim të korrigjimit të tatimit sa herë që shumën e tatimit të aplikuar në faturën tatimore tejkalon tatimin faktik për atë furnizim të tatueshëm.

1.5 “Vlera doganore” nënkupton vlerën e përgjithshme mbi të cilën llogariten detyrimet doganore në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

1.6 “Notë debiti” nënkupton një dokument të lëshuar nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave dhe shërbimeve pasi të jetë lëshuar fatura tatimore që lëshohet me qëllim të korigjimit të tatimit sa herë që shuma e tatimit të aplikuar në faturën tatimore është më pak sesa tatimi faktik për atë furnizim të tatueshëm.

1.7 “Veprimtari ekonomike” nënkupton veprimtarinë e zhvilluar për qëllim të krijimit të fitimit.

1.8 “Përjashtim” nënkupton ato importe, hyrjet dhe furnizime në Kosovë nga RFJ, të përmendura në nenin 11, të cilat janë jashtë fushëveprimit të tatimit mbi vlerën e shtuara dhe për të cilat, si rrjedhim, pranuesi i mallrave nuk paguan tatim mbi vlerën e shtuar.

1.9 “Furnizim i përjashtuar” nënkupton një furnizim, të përshkruar në nenin 12, për të cilin furnizuesi nuk e mbledh tatimin mbi vlerën e shtuar.

1.10 “Eksport” nënkupton mallin që del nga Kosova për një shtet tjetër, duke përfshirë furnizimin i cili kalon tranzit nëpër pjesë të tjera të Republikës Federale të Jugosllavisë.

1.11 “Shërbimet financiare” nënkupton një ose disa prej veprimtarive vijuese:

(a) Këmbimi i valutave nëpërmjet këmbimit të banknotave apo monedhave, duke kredituar apo debituar llogaritë dhe e kunderta;

(b) Lëshimi, pagesa, pranimi ose transferimi i pronësisë së çekut apo letërkredisë;

(c) Dhënia e kredisë, rinovimi dhe ndryshimi i kushteve të kontratës së kredisë;

(ç) Lëshimi, caktimi, tërheqja, pranimi, regjistrimi, garantimi, rinovimi, ndryshimi apo transferimi i pronësisë së një letre me vlerë;

(d) Dhënia, marrja, ndryshimi ose lëshimi i një garancie, i një dëmshpërblimi, i një letre me vlerë apo obligacioni lidhur me kryerjen e detyrimeve nëpërmjet mbulimit me çek, kontratë kredie, aksione, obligacione, pjesëmarrje ose në lidhje me aktivitetet e specifikuar në nënparagrafet e mësipërme prej b) deri në ç);

(dh) Dhënia apo transferimi i pronësisë së një kontrate të sigurimit jetësor apo të risigurimit lidhur me ndonjë kontratë të tillë;

(e) Pagesa apo arkëtimi i ndonjë shume të interesit të përgjithshëm, dividendit apo çfarëdo shume tjetër që ka të bëjë me ndonjë detyrim, aksion, pjesëmarrje, kontratë kredie, kontratë të sigurimit jetësor, sistem të pensionimit apo kontrate për të ardhmen dhe

(ë) Kryerja, përfshirja ose marrja përsipër për të kryer çdonjërin prej aktiviteteve të specifikuar në paragrafët prej a) deri në ë).

1.12 “Mallra” nënkupton të gjitha llojet e pasurisë me përjashtim të parave.

1.13 “Import” nënkupton mallrat që hyjnë në Kosovë nga një shtet tjetër qoftë drejtëpërdrejt apo pas kalimit tranzit nëpër ndonjë pjesë tjetër të Republikës Federale të Jugosllavisë.

1.14 “Hyrje nga RFJ” nënkupton mallrat që hyjnë në Kosovë nga një pjesë tjetër e Republikës Federale të Jugosllavisë.

1.15 “Dalje drejt RFJ-së” nënkupton mallrat që dalin nga Kosova për një pjesë tjetër të Republikës Federale të Jugosllavisë.

1.16 “Tatim i zbritshëm” nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar të paguar nga personi i tatueshëm për blerjet e tatueshme, duke përfshirë tatimin e paguar në import apo për hyrje nga RFJ.

1.17 “Organizata joqeveritare” nënkupton organizatën joqeveritare të regjistruar në UNMIK sipas Rregullores 1999/22 të datës 15 nëntor 2001 mbi Regjistrimin dhe veprimin e organizatave joqeveritare në Kosovë.

1.18 “Vlerë e hapur e tregut” nënkupton çmimin me të cilin mallra të ngjashëm si për nga sasia ashtu edhe nga cilësia i shiten një blerësi i cili është tërësisht i pavarur nga shitësi në një transaksion të lirë të tregut.

1.19 “Tatim i llogaritur” nënkupton TVSH-në e aplikuar në furnizimin e tatueshëm të bërë nga personi i tatueshëm.

1.20 “Person” nënkupton çdo person fizik apo juridik, publik apo privat, duke përfshirë pa u kufizuar vetëm në sipërmarrjet individuale afariste, ortakëritë dhe organizatat e tjera afariste, autoritetet komunale dhe publike.

1.21 “Person i lidhur” nënkupton çdo person me lidhje speciale me personin tjetër që mund të ndikojë në transaksionet e lira të tregut.

1.22 “Furnizim i shërbimeve” nënkupton çdo furnizim që nuk është furnizim i mallrave.

1.23 “Furnizim i mallrave” nënkupton transferimin e të drejtës për të shitur pasurinë materiale si pronar.

1.24 “Furnizim i tatueshëm” nënkupton furnizimin e mallrave apo shërbimeve nga personi i tatueshëm. Furnizimi i tatueshëm përfshin furnizimet e tatueshme me zero për qind, por nuk përfshin furnizimet e përjashtuara nga tatimi.

1.25 “Person i tatueshëm” nënkupton çdo person i cili gjatë kryerjes se një aktiviteti ekonomik:

(a) importon, eksporton, fut mallra nga RFJ-ja apo nxjerr mallra drejt RFJ-së,

(b) duke mos qenë person që referohet në nenin 1.25 (a), furnizon me mallra apo shërbime dhe ka një qarkullim që tejkalon limitin e regjistrimit të paraqitur në nenin 3.4 të kësaj rregulloreje.

1.26 “Administrata tatimore” nënkupton Administratën Tatimore të Autoritetit Qendror Fiskal.

1.27 “Autoritetet tatimore” nënkupton Administratën Tatimore dhe Shërbimin Doganor të UNMIK-ut.

1.28 “Fatura tatimore” nënkupton një dokument të cilin duhet ta lëshojë një person i tatueshëm në pajtim me nenin 14 përkitazi me një furnizim të tatueshëm me qëllim që të njoftojë detyrimin për të kryer pagesën.

1.29 “Qarkullim” nënkupton të hyrat bruto të një personi nga të gjitha furnizimet që ai person i ka kryer në Kosovë.

1.30 “Furnizime të tatueshme me zero për qind” nënkupton një furnizim të tatueshëm të përshkruar në nenin 10 për të cilin shkalla e tatimit mbi vlerën e shtuar është zero për qind (0%) e vlerës së tatueshme.

Kapitulli II

Vendosja e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe regjistrimi

Neni 2

Tatimi mbi vlerën e shtuar

- 2.1 Nga 1 korriku i vitit 2001 një tatim mbi vlerën e shtuar, shkurt TVSH, do të vilet në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje mbi vlerën e tatueshme të importeve, hyrjeve nga RFJ dhe furnizimeve të tatueshme.
- 2.2 Tatimi mbi vlerën e shtuar do të vilet në masën prej 15% mbi vlerën e tatueshme të importeve, hyrjeve nga RFJ dhe furnizimeve të tatueshme përveç për furnizimet e tatueshme me zero për qind .
- 2.3 Tatimi mbi vlerën e shtuar do të vilet në masën prej 0% mbi vlerën e tatueshme të furnizimeve të tatueshme me zero për qind të përshkruara në nenin 10 të kësaj rregullore.

Neni 3

Detyrimi për t'u regjistruar

- 3.1 Personi i tatueshëm duhet të kërkojë që të regjistrohet në Administratën tatimore për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore.
- 3.2 Kur personi bëhet person i tatueshëm pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, personi duhet të kërkojë të regjistrohet për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar brenda 15 ditësh nga data kur ai person bëhet person i tatueshëm.
- 3.3 Qarkullimi për qëllime të përcaktimit të limitit të regjistrimit sipas përkufizimit të dhënë në nenin 1.25(b) do të llogaritet duke u bazuar në konsideratën totale të pranuar nga personi.
- 3.4 Kufiri i regjistrimit do të jetë qarkullimi prej 200.000 DM për një vit kalendarik.
- 3.5 Personi i tatueshëm i cili importon apo fut mallra nga RFJ ose nxjerr mallra në RFJ, duhet të kërkojë për t'u regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar pavarësisht nga kufiri i vendosur në nenin 3.4.
- 3.6 Bashkëkryesuesit e AQF-së mundën, sipas nevojës, të lëshojnë një udhëzim administrativ duke specifikuar procedurën me të cilën çdo furnizues, i cili nuk është kërkuar të regjistrohet, mund të vendosë të regjistrohet për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Neni 4

Procedura për regjistrim

- 4.1 Kërkesa për t'u regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar duhet të bëhet në formatin që do të vendoset në udhëzimin administrativ i cili do të lëshohet nga bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal.
- 4.2 Kur të regjistrohet personi për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar, Administrata tatimore do t'i lëshojë personit një certifikatë të regjistrimit që përmban një numër unik identifikues të tatimpaguesit. Regjistrimi hyn në fuqi në datën e shënuar në certifikatën e regjistrimit.

4.3 Administrata tatimore mund të regjistrojë çdo person të tatueshëm për tatimin mbi vlerën e shtuar, pavarësisht se a ka kërkuar ai person të regjistrohet dhe ai regjistrim të hyjë në fuqi në datën kur personi i tillë ka fituar të drejtën e regjistrimit.

Neni 5 Çregjistrimi nga regjistri i TVSH

5.1 Varësisht nga neni 5.2, personi i tatueshëm i cili mbyll biznesin e tij ose nuk angazhohet më në veprimtari ekonomike duhet të kërkojë të largohet nga regjistri jo më larg se 15 ditë pas ditës së fundit në të cilën personi ka kryer apo kontraktuar të kryejë importe apo furnizime të tatueshme.

5.2 Personi i tatueshëm mund të kërkojë të largohet nga regjistri nëse në përputhje me periudhën e fundit dymbëdhjetëmujore furnizimet e tatueshme të personit të tillë nuk kanë tejkaluar limitin e paraqitur në nenin 3.4; me kusht që asnjë kërkesë e tillë për largim të mos jetë bërë gjatë periudhës prej dymbëdhjetë muajve ngadata kur regjistrimi ka hyrë në fuqi.

5.3 Administrata tatimore mund të largojë nga regjistri çdo person, i cili nuk është i detyruar të regjistrohet sipas kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur një person i tillë është regjistruar në përputhje me procedurën që i referohet nenit 3.6 dhe vendos të vazhdojë të mbetet i regjistruar.

Kapitulli III **Furnizimi**

Neni 6 Furnizimi i mallrave

6.1 Furnizimi i mallrave do të përfshijë ndër të tjera sa vijon:

- (a) Furnizimin me rrymë, ujë, gaz, ngrohje, ftohje apo ajër të kondicionuar,
- (b) Furnizimin e mallrave të kryer nga një agjent në emër të personit të tatueshem, i cili do të trajtohet si furnizim i kryer nga vetë personi i tatueshem,
- (c) Furnizimin sipas një marrëveshjeje të blerjes me këstë apo për shitjen e mallrave në afate të shtyra, të cilat sigurojnë se pronësia do të kalojë me kryerjen e pagesës së këstit përfundimtar,
- (ç) Furnizimin e marrë nga personi i tatueshëm për nevoja të tij personale dhe furnizimin që konsumohet në biznesin e personit,
- (d) Dhënien e mallrave me qëra,
- (dh) Furnizimin e mallrave nga personi i tatueshëm për punëtorët e personit, duke përfshirë furnizimet falas;
- (e) Transferimin e afarizmit apo një pjese të afarizmit, subjekt i nenit 6.2.

6.2 Furnizimi nga një person i tatueshëm i mallrave të tatueshme si pjesë e transferimit të afarizmit apo të një pjese të afarizmit të një person tjetër i tatueshëm nuk konsiderohet si furnizim i

tatueshëm i mallrave, nëse përfituesi është i regjistruar ose regjistrohet sipas kësaj rregulloreje brenda tridhjetë (30) ditëve të një transferimi të tillë.

Neni 7 Furnizimi i shërbimeve

7.1 Furnizimi i shërbimeve ndër të tjera përfshinë sa vijon:

(a) Furnizimin e shërbimeve të kanalizimit të ujrave të zeza, mbledhjen e dherave e mbeturinave sipas një tarife të organeve komunale apo publike dhe

(b) Furnizimin e shërbimeve të kryera nga një agjent në emër të personit të tatueshëm, i cili trajtohet si furnizim i kryer nga personi i tatueshëm.

7.2 Furnizimi i shërbimeve nuk përfshin asnjë lloj pune ku i punësuar kryen shërbimet e tij apo të punëdhënësit gjatë punësimit për pagë.

Neni 8 Vlera e tatueshme e furnizimeve

8.1 Vlera e tatueshme e furnizimit të tatueshëm në Kosovë do të jetë pagesa (konsiderata) e përgjithshme e pagueshme për atë furnizim.

8.2 Vlera e tatueshme e një importi është vlera doganore e importit plus detyrimet doganore, akciza apo tatimet dhe detyrimet e tjera të aplikueshme, pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar.

8.3 Vlera e tatueshme e hyrjes së një malli nga RFJ do të jetë pagesa e përgjithshme e pagueshme për atë furnizim.

8.4 Vlera e tatueshme e furnizimit të bërë të një personi të lidhur për pagesë (konsideratë), por që është më e ulët se vlera e hapur e tregut për atë furnizim mednohet të jetë vlera e hapur e tregut për atë furnizim. Procedura për vendosjen e vlerës së hapur të tregut të një furnizimi të tatueshëm do të përcaktohet me anë të një udhëzimi administrativ e cila do të lëshohet nga bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal.

8.5 Vlera e tatueshme e furnizimit për shfrytëzim personal, për mallrat e dhëna me qëra, për mallrat e transferuara për këmbim apo për dhuratë është vlera e hapur e tregut të atij furnizimi.

8.6 Aty ku shuma e tatimit të vlerës së shtuar nuk është e ndarë veçmas në faturën tatimore, vlera e tatueshme do të jetë çmimi i përgjithshëm, minus TVSH e përfshirë në atë çmim.

8.7 Aty ku bëhet pagesa për furnizimin e tatueshëm si dhe për furnizimin i cili nuk është furnizimi i tatueshëm, vlera e tatueshme është pjesa e pagesës që i përket furnizimit të tatueshëm.

8.8 Vlera e tatueshme e furnizimit të tatueshëm që ka zbritje çmimi është vlera e tatueshme e furnizimit, minus zbritja e çmimit.

8.9 Vlera e tatueshme e furnizimit të tatueshëm që ka ngritje çmimi do të jetë vlera e tatueshme e furnizimit të rritur me ngritjen e çmimit.

Neni 9
Vendi i furnizimit

9.1 Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me rregulloren e tanishme, furnizimi i mallrave në Kosovë ndodh në vendin ku mallrat janë bërë gati për blerësin nga furnizuesi.

9.2 Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me rregulloren e tanishme, furnizimi i shërbimeve, duke përfshirë edhe shërbimin e transportit, bëhet në vendin e biznesit të furnizuesit të shërbimit dhe nëse kjo nuk mund të caktohet, atëherë në vendin ku shërbimet janë përfituar.

9.3 Një blerje që ka të bëjë me tokën ose me ndërtësat ndodh në vendin ku gjendet pasuria.

Kapitulli IV
Përqindja zero, blerja e përjashtuar, furnizimi i përjashtuar dhe rikthimi

Neni 10
Furnizimet e tatueshme me zero për qind

10.1 Furnizimet e mëposhtme konsiderohen furnizime të tatueshme me përqindje zero (0%):

- (a) Eksportet dhe daljet e mallrave drejt RFJ-së dhe
- (b) Mallrat dhe shërbimet lidhur me transportimin ndërkombëtar të mallrave apo të udhëtarëve.

10.2 Dëshmia që kërkohet për të vendosur se ka ndodhur një eksport apo dalje e mallrave drejt RFJ-së, përcaktohet në një udhëzim administrativ që lëshohet nga bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal.

Neni 11
Blerjet e përjashtuara

11. Tatimi mbi vlerën e shtuar nuk aplikohet në blerjet e mëposhtme:

(a) importimi i sendeve personale të udhëtarit të lejuara sipas dispozitave të aplikueshme të Doganës;

(b) importi i mallrave pa doganë të turistëve të lejuara sipas dispozitave të aplikueshme të Doganës;

(c) importet, hyrjet nga RFJ apo furnizimet e financuara nga paratë e donacioneve të bëra për UNMIK-un apo departamentet e Strukturës së Përbashkët të Përkohshme Administrative nga qeveritë, agjencitë qeveritare, organizatat qeveritare apo joqeveritare në mbështetje të programeve dhe projekteve humanitare dhe rindërtuese në Kosovë;

(ç) importet apo hyrjet nga RFJ të kryera nga përfaqësuesit diplomatikë apo furnizimet e kryera për përfaqësuesit diplomatikë ose nga zyrat e ndërlidhjes në përputhje me rregulloren e UNMIK-ut nr.. 2000/42 të datës 10 korrik 2000 mbi Vendosjen dhe funksionimin e zyrave të ndërlidhjes në Kosovë;

(d) importet apo hyrjet nga RFJ të kryera nga Kombet e Bashkuara, furnizimet e kryera për Kombet e Bashkuara apo ndonjërin prej organeve të saj, duke përfshirë UNMIK-un (siç është

përcaktuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/47 të datës 18 gusht 2000 mbi Statusin, privilegjet dhe imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë), agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, Bankën Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe

- (dh) importet apo hyrjet e barnave nga RFJ, shërbimet mjekësore e instrumentet mjekësore dhe
- (e) gjoba apo ndëshkimi i vënë nga autoritetet e UNMIK-ut.

Neni 12 Furnizimet e përjashtuara

12.1 Furnizimet e mëposhtme konsiderohen furnizime të përjashtuara:

- (a) Furnizimet e barnave, shërbimeve mjekësore apo instrumenteve mjekësore;
- (b) Furnizimet e shërbimeve të arsimit publik;
- (c) Furnizimet e shërbimeve financiare;
- (ç) Transferimi i titullit të pronësisë, qiraja e tokës dhe e shtëpive të banimit;
- (d) Furnizimi i kryer nga një person i cili importon apo kryen hyrje nga RFJ, por qarkullimi i të cilit nuk tejkalon limitin e paraqitur në nenin 3.4 dhe
- (dh) Dhënia e lejeve apo licencave për një tarifë nga autoriteti lokal apo autoriteti publik;

Neni 13 Rabatet

13.1 Aty ku një person, sipas nenit 13.2, importon ndonjë mall apo kryen ndonjë hyrje të mallrave nga RFJ, Autoriteti Qendror Fiskal, në varësi të nenit 13.3, do t'ia rikthejë personit shumën e tatimit mbi vlerën e shtuar të paguar nga personi gjatë importit apo hyrjes nga RFJ.

13.2 Sipas nenit 13.1 këta persona të mëposhtëm kanë të drejtë në rabat:

- (a) kontraktuesit për UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-i, Banka Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare, me kusht që të dëshmojë se mallrat e sjellura në Kosovë do të shfrytëzohen ekskluzivisht për përmbushjen e një kontrate me UNMIK-un, për agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, Bankën Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare,
- (b) organizatat joqeveritare me status të përfitimit publik me kusht që të provojnë se mallrat e sjellur në Kosovë do të shfrytëzohen për përfitim publik. Rabati nuk do të lejohet në lidhje me sjelljen e alkoolit, pijeve alkoolike, pijeve freskuese, cigareve, purove, purretave dhe prodhimeve të tjera të duhanit, prodhimeve të naftës dhe parfumeve apo kozmetikës.

13.3 Prova e kërkuar sipas nenit 13.2 do të përcaktohet në udhëzimin administrativ, i cili do të lëshohet nga bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal.

13.4 Për të kërkuar rabatin sipas nenit 13.2, personi i cili ka të drejtë në këtë duhet t'ia bëjë një kërkesë Administratës tatimore në përputhje me procedurën që do të caktohet në udhëzimin administrativ të lëshuar nga bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal.

Kapitulli V

Fatura tatimore, momenti i lindjes së detyrimit dhe pagimi

Neni 14 Fatura tatimore

14.1 Personi i tatueshëm i cili kryen një furnizim të tatueshëm duhet t'i lëshojë personit i cili pranon furnizimin një faturë tatimore lidhur me atë furnizim.

14.2 Për një furnizim të tatueshëm në Kosovë, për hyrjet dhe daljet nga RFJ, faturë tatimore është fatura komerciale. Informatat e kërkuara që duhet t'i përmbajë një faturë e tillë do të specifikohen në një udhëzim administrativ që do të lëshohet nga bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal.

14.3 Për importe apo eksporte fatura tatimore do të jetë deklarata e unifikuar doganore sipas dispozitave të zbatueshme doganore.

Neni 15 Korrigjimet

Kur shuma e tatimit në vlerën e shtuar e ngarkuar në faturën tatimore është më e vogël apo më e madhe se sa TVSH aktuale e pagueshme për atë furnizim, furnizuesi duhet ta lëshojë sipas rastit një notë krediti apo një notë debiti.

Neni 16 Momenti i lindjes së detyrimit tatimor

16.1 Për një furnizim të tatueshëm në Kosovë, detyrimi për tatimin mbi vlerën e shtuar lind sipas metodës akruale[1] të kontabilitetit kur ndonjëra nga ngjarjet e mëposhtme ndodh e para:

- (a) kur fatura lëshohet,
- (b) kur mallrat janë bërë të disponueshme për konsumatorin apo kur të jenë kryer shërbimet për klientin dhe
- (c) kur është marrë pagesa.

16.2 Për një furnizim të tatueshëm që është i vazhdueshëm, detyrimi për tatimin mbi vlerën e shtuar lind sa herë që lëshohet fatura dhe nëse pagesa është kryer më herët, në kohën kur është kryer pagesa.

16.3 Aty ku konsiderata është pranuar në llogari përpara se shërbimi të jetë kryer, tatimi ngarkohet në momentin e marrjes së pagesës. Atëherë kur kryhen dy a më shumë pagesa për një furnizim të tatueshëm, detyrimi për tatimin mbi vlerën e shtuar lind në kohën e çdo pagese.

16.4 Për importet, detyrimi për tatimin në vlerën e shtuar lind në përputhje me dispozitat në fuqi të shërbimit të doganave dhe nëse këto dispozita mungojnë, atëherë këto detyrime lindin në momentin e importimit.

16.5 Për hyrjet nga RFJ detyrimi i tatimit mbi vlerën e shtuar lind në momentin e hyrjes në Kosovë të atij furnizimi.

16.6 Detyrimi për tatimin në vlerën e shtuar për eksportet lind në kohën e përshkruar në përputhje me dispozitat e aplikueshme doganore dhe nëse këto dispozita mungojnë, atëherë detyrimi lind në momentin e eksportit.

16.7 Për daljet drejt RFJ-së detyrimi i tatimit mbi vlerën e shtuar lind në kohën e daljes nga Kosova të atij furnizimi.

Neni 17 Deklarimi dhe pagesa

17.1 Një person i tatueshëm duhet të dorëzojë deklaratën tatimore jo më vonë se ditën e fundit të muajit kalendarik pas përfundimit të secilës periudhë tatimore dhe të paguajë me kohë tatimin në vlerën e shtuar për atë periudhë tatimore ose para datës së caktuar për deklarim.

17.2 Formulari i deklarimit, vendi ku formulari do të dorëzohet dhe mënyra e pagesës së tatimit në vlerën e shtuar do të specifikohen në udhëzim administrativ që do të lëshohet nga bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal.

Neni 18 Tatimi i pagueshëm

18.1 Përveç rasteve kur ndryshe parashihet në këtë rregullore, totali i tatimit të pagueshëm mbi vlerën e shtuar nga personi i tatueshëm për periudhën tatimore është vlera totale e tatimit të llogaritur sipas nenit 20, minus totali i tatimit të zbritshëm i llogaritur sipas nenit 21.

18.2 Kur një import apo hyrje nga RFJ e një mjeti kryesor është kryer nga personi i tatueshëm i cili fillon biznesin e ri, atëherë tatimi mbi vlerën e shtuar që duhet paguar për atë import apo hyrje nga RFJ do të shtyhet dhe do të shlyhet kundrejt tatimit të llogaritur, të cilin personi i tatueshëm do ta paguajë gjatë periudhës prej gjashtë muajve nga data e importit të tillë apo hyrjes së tillë. Procedura e një shtyrjeje të tillë do të caktohet në një udhëzim administrativ të lëshuar nga bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal.

18.3 Shtyrja do të lejohet vetëm në rast të një garancie bankare. Kur personi i tatueshëm nuk e shlyen tërësisht apo pjesërisht shumën e shtyrë brenda periudhës prej gjashtë muajve nga data e importit apo hyrjes nga RFJ, personi i tatueshëm duhet të paguajë menjëherë shumën e pashlyer. Pagesa konsiderohet të jetë tatimi i zbritshëm i paguar në lidhje me mallin, mjetin kryesor të referuar sipas nenit 18.2.

Neni 19 Përiudhat tatimore

19.1 Për furnizimin e tatueshëm në Kosovë, duke përfshirë hyrjet nga RFJ, periudha tatimore do të jetë çdo muaj kalendarik, përveç rasteve kur ndryshe parashihet në këtë rregullore.

19.2 Për importime tatimi duhet paguar nga importuesi në të njëjtën mënyrë sikurse detyrimet e tjera të importit të përshkruara në pajtueshmëri me dispozitat doganore në fuqi.

19.3 Kur një person i tatueshëm është regjistruar për të parën herë, periudha tatimore fillon nga data kur regjistrimi hyn në fuqi dhe përfundon në ditën e fundit të të njëjtit muaj kalendarik.

19.4 Kur një person i tatueshëm është larguar nga regjistri për tatimin mbi vlerën e shtuar, periudha tatimore fillon nga dita e parë e muajit kalendarik në të cilin personi i tatueshëm është çregjistruar dhe përfundon në ditën e çregjistrimit të personit të tatueshëm.

19.5 Bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal me një udhëzim administrative mund t'i ndryshojnë periudhat tatimore për çdo kategori të personave të tatueshëm.

19.6 Periudha e parë tatimore do të fillojë më 1 korrik 2001.

Neni 20 Tatimi i llogaritur

Tatimi i llogaritur total për një periudhë tatimore është:

- (a) shuma e vlerës së tatueshme të furnizimeve të tatueshme me zero (0%) për qind, e shumëzuar me zero (0%) për qind,
- (b) plus e vlera e tatueshme e furnizimeve të tatueshme, përveç furnizimeve të tatueshme me zero për qind, të kryera gjatë periudhës tatimore e shumëzuar me pesëmbëdhjetë (15%) për qind

Neni 21 Tatimi i zbritshëm

21.1 Përveç rasteve kur ndryshe parashihet në këtë rregullore, tatimi i zbritshëm që mund të zbritet nga tatimi i llogaritur për periudhen tatimore, përfshin:

- (a) Totalin e tatimit mbi vlerën e shtuar të paguar nga personi i tatueshëm në blerjet e tatueshme, duke përfshirë mjetet kryesore gjatë periudhës tatimore dhe
- (b) Totalin e tatimit mbi vlerën e shtuar të paguar nga personi i tatueshëm në importimin dhe hyrjet e mallrave nga RFJ gjatë periudhës tatimore.

21.2 Zbritje e tatimit të zbritshëm nuk lejohet për tatimin mbi vlerën e shtuar të paguar në lidhje me furnizimet të cilat nuk janë përdorur për furnizime të tatueshme të kryera nga personi i tatueshëm.

21.3 Zbritje e tatimit të zbritshëm nuk lejohet për tatimin në vlerën e shtuar të paguar në lidhje me furnizimet nëse pretenduesi nuk është në zotërim:

- (a) dokumentet origjinale dhe autentike doganore për import apo eksport që do të saktësohen në një udhëzim administrativ të bashkëkryesuesve të Autoritetit Qendror Fiskal,
- (b) për të gjitha transaksionet, një faturë autentike e lëshuar nga personi i tatueshëm dhe
- (c) të provave dokumentare se borxhi është borxh i keq, sipas nenit 22.

21.4 Nuk lejohet zbritje e tatimit të zbritshëm lidhur me furnizimet e përjashtuara sipas nenit 12.

Neni 22 Borxhi i keq

22.1 Aty ku totalisht apo pjesërisht një pagesë për furnizimin e tatueshëm nuk është marrë nga furnizuesi dhe është kthyer në borxh të keq, pakësimi i tatimit mund të lejohet sipas këtij neni.

22.2 Pakësimi e tatimit lejohet në çdo periudhë tatimore pasi borxhi të jetë kthyer në borxh të keq. Borxhi nuk mund të shndërrohet në borxh të keq më herët se gjashtë muaj pas mbylljes së periudhës tatimore për të cilën tatimi mbi vlerën e shtuar në shumën e paarkëtuar është paguar.

22.3 Shuma e pakësuar e tatimit të lejuar sipas këtij neni është tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar në lidhje me furnizimin që i përgjigjet shumës së paarkëtuar të borxhit të keq.

22.4 Aty ku pakësimi i tatimit është lejuar për borxh të keq dhe tërësisht apo pjesërisht ai borxh është arkëtuar më vonë, personi i tatueshëm do t'i ripaguajë administratës tatimore pjesën e asaj shume të kredituar në lidhje me borxhin e arkëtuar.

Neni 23

Tatimi i paguar tepër dhe refundimi

23.1 Në qoftë se totali i paguar i tatimit të zbritshëm për periudhën tatimore tejkalon totalin e tatimit të llogaritur për atë periudhë, personi i tatueshëm mund ta bartë tepricën e tatimit të paguar tepër në periudhën e ardhshme tatimore dhe në çdo periudhë të metëjme tatimore ku mund të aplikohet. Tatimi i tepërt i bartur mund të përdoret për të pakësuar tatimin e llogaritur në periudhat tatimore të mëpasshme.

23.2 Një person i tatueshëm mund të kërkojë refundimin e tatimit të paguar tepër nëse:

(a) personi i tatueshëm e ka bartur një shumë të tatimit të paguar tepër për një periudhë vazhduese prej gjashtë muajsh dhe

(b) shuma e tatimit të paguar tepër tejkalon 10.000 DM

23.3 Për eksporte dhe daljet drejt RFJ-se, një rimbursim mund të kërkohej edhe nëse nuk është bartur shuma e paguar tepër e tatimit për se paku gjashtë muaj të njëpasnjëshëm, me kusht që:

(a) Shuma e tatimit të zbritshëm të personit të tatueshëm në lidhje me eksportet dhe daljet e vazhdueshme të mallrave drejt RFJ-së për më shumë se gjashtë muaj brenda periudhës dymbëdhjetëmuajore, e tejkalon detyrimin e tyre të tatimit të llogaritur.

(b) Personi i tatueshëm zbaton me korrektësi të gjitha dispozitat doganore dhe tatimore në fuqi dhe

(c) kërkesat për refundim bëhen jo më shumë se një herë në tre muaj ose kur tatimi i paguar tepër tejkalon shumën prej 10.000 DM, ato mund të bëhen edhe çdo muaj kalendarik.

Kapitulli VI Të drejtat dhe detyrimet

Neni 24

Autoritetet tatimore

24.1 Administrata tatimore e ka përgjegjësinë ekskluzive për të administruar tatimin e vlerës së shtuar.

24.2 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut në emër të administratës tatimore e vlerëson, vjelë dhe arkëton tatimin mbi vlerën e shtuar në import dhe eksport dhe, sipas nevojës, ndërmerr funksione të tjera lidhur me administrimin e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Neni 25

Detyrimi për të informuar rreth ndryshimeve

Personi i tatueshëm duhet ta informojë Administratën tatimore me shkrim brenda 15 ditësh për çfarëdo ndryshimi në lidhje me emrin e personit, adresën, aktivitetin ekonomik dhe me informata të tjera të cilat u janë dhënë autoriteteve tatimore në kohën e regjistrimit.

Neni 26

Detyrimi për të mbajtur regjistrime

Një person i tatueshëm duhet të mbajë librat dhe regjistrimet lidhur me tatimin në vlerën e shtuar siç do të specifikohet në një urdhëresë administrative të mëpasme.

Neni 27

Inspektimi i shënimeve, vlerësimet, interesi, mbledhja e detyrueshme

Në administrimin e tatimit në vlerën e shtuar, autoritetet tatimore ndër të tjera munden në pajtim me ligjin në fuqi:

- (a) kërkojnë paraqitjen e dokumenteve dhe informatave të tjera përkatëse;
- (b) të lëshojnë njoftimin për vlerësim;
- (c) të lëshojnë kërkesën për pagesë;
- (ç) të lëshojnë kërkesën për interes;
- (d) të kryejë kontrollin e dokumenteve dhe deklaratave;
- (dh) të bëjnë mbledhjen e detyrueshme për tatimin e papaguar.

Neni 28

Kundërvajtjet dhe ndëshkimet

Çdo person i tatueshëm, i cili kryen kundërvajtje tatimore duhet t'i nënshtrohet dënimeve sipas ligjit në fuqi, duke përfshirë ato të përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/20 të 12 prillit 2000 mbi Administratën dhe procedurat tatimore.

Neni 29

Ankesa

29.1 Secili person që pohon se një vendim zyrtar sipas kësaj rregulloreje është i gabuar, mund të bëjë ankesë ndaj një vendimi të tillë në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut nr..2000/20.

29.2 Çfarëdo veprimi apo vendimi nga ana e autoriteteve tatimore në administrimin e tatimit në vlerën e shtuar, duke përfshirë edhe ato të shënuara në nenin 27 më lart, do të konsiderohen si një vendim zyrtar për qëllimet e të drejtës së tatimpaguesit në ankesë.

Kapitulli VII **Zbatimi**

Neni 30 Zbatimi

30. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 31 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore zëvendëson çfarëdo dispozitë në ligjet në fuqi që nuk është në përputhje me të.

Neni 32 Shfuqizimi

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/3 e datës 22 janar 2000 dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/5 e datës 1 shkurt 2000 shfuqizohen që nga 1 korriku i vitit 2001. Shfuqizimi nuk do të ndikojë në çfarëdo detyrimi të papaguar të tatimit në shitje apo të tatimit në hotele, ushqim dhe pije të mbetur që kanë lindur para 1 korrikut të vitit 2001.

Neni 33 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 maj të vitit 2001.

Hans Haekkerup
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

[1] Metoda akruale e kontabilitetit sipas të cilës të ardhurat paraqiten atëherë kur fitohen e jo kur merren dhe shpenzimet paraqiten kur ato ndodhin e jo kur paguhen.